



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHETETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 2639 Prot.

Tiranë, më 24.05.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1403/1 PROT., DATË 19.05.2025 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË
VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË ANKESËS SË
PARAQITUR NGA SHTETASI Z. ARTUR BEJLERI”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Artur Bejleri, me nr. 2000 prot., datë 11.09.2020, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratit E.R, me detyrë prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe me vendimin 1403/1 prot., datë 19.05.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Artur Bejleri”, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Medar Shtylla”, Kompleksi “Kika”, Komuna e Parisit, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

